

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

MANJA TAKIM ME PRESIDENTIN E KOMITETIT EVROPIAN PËR PARANDALIMIN E TORTURËS (CPT), Z. ALAN MITCHELL

LEXO PËR MË SHUMË ☀



Manja takoi presidentin e Komitetit Evopian për Parandalimin e Torturës (CPT), z. Alan Mitchell dhe delegacionin e tij, ku konfirmuan qëndrimet e përbashkëta për raportin e monitorimit mbi kushtet e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Shqipëri për vitin 2023. Manja garantoi si Ministër i Drejtësisë dhe në emër të Qeverisë Shqiptare, bashkëpunim të ngushtë me CPT dhe Avokatin e Popullit përmirësimin e kushteve të trajtimit, me fokus në sigurinë, trajtimin social dhe kujdesin mjekësor për të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit, në veçanti ata me masa mjekësore.

DRENOVË, KORÇË - UNIFORMAT E REJA, NJË PREMTIM I MBAJTUR!

LEXO PËR MË SHUMË ☀

Në Drenovë të Korçës, u bë shpërndarja e uniformave të reja për policinë e burgjeve. Manja theksoi se kapitali njerëzor në sistemin penitenciar është aseti më i çmuar dhe qeveria është e vendosur për të garantuar standartet më të mira për punën e tyre në një sektor delikat për sigurinë kombëtare.



KORÇË – INAGUROHET ZYRA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

LEXO PËR MË SHUMË ☀



Inagurohet zyra e Ndihmës Juridike Falas në Korçë, e cila është e 20-ta në rang kombëtar dhe lehtëson aksesin e qytetarëve në marrjen e shërbimeve ligjore falas. Zyra e Korçës është pjesë e suksesit në bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me UNDP dhe ADA. Manja falenderon UNDP-në me përfaqësueset znj. Monica Merino dhe Ambasadorin e Austrisë në Shqipëri, Dr. Christian Steiner, si partnerë që ndihuan të çojmë përpara vizionin tonë për këtë shërbim, shtyllë e rëndësishme e shtetit social!

MINISTRIA E DREJTËSISË – ARRITJET 2023 DHE OBJEKTIVAT PËR 2024

LEXO PËR MË SHUMË ☀



Ministria e Drejtësisë zhvilloi analizën vjetore për vitin 2023 dhe përcaktoi synimet e reja për vitin 2024. Në analizë, Ministri Manja vendosi theksin te vleresimi i burimeve njerëzore si aseti më i çmuar dhe te përkushtimi ndaj qytetarëve, për të ecur përpara.

MANJA TAKIM ME ZNJ. GIULIA RE, DREJTUESEN E ZYRËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS NË SHQIPËRI

LEXO PËR MË SHUMË ☀

Takim kortezie dhe pune me znj. Giulia Re, Drejtuesen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri! Projektet tona me KiE-në mbështesin eficencën e sistemit të drejtësisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, çështjen e pronave dhe trajtimin dinjitoz të të dënuarve në institucionet tona të ekzekutimit të vendimeve penale. Ministri Manja shprehu se me znj. Giulia Re dhe ekipin e saj të KiE-së në Tiranë do të vazhdohet bashkëpunimi i shkëlqyer në fushat e mësipërme!



MANJA TAKIM ME Z. YOUSSEF BALLA, AMBASADOR I MBRETËRISË SË MAROKUT NË ITALI

LEXO PËR MË SHUMË ☀



Marrëdhëniet tona me Mbretërinë e Marokut në fushën e drejtësisë nuk kanë asnjë pengesë ligjore dhe kjo u dëshmua me ekstradimin nga Maroku të një personi të shpallur në kërkim ndërkombëtar, për një krim të rëndë të kryer në Shqipëri, duke u bazuar te konventa e ekstradimit, pa pasur një marrëveshje dypalëshe ekstradimi! Ministri Manja pranoi me kënaqësi ftesën e homologut të tij maroken për një vizitë në Marok, për të thelluar dhe konkretizuar më tej bashkëpunimin në fushën e drejtësisë me marrëveshje dypalëshe në fusha të tjera.



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministria_drejttesise
ulsimanja



@manja_uls